



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 24

Datë: 12. 05. 2020. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
 - 2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor të punës i KQZ-së 2019, për Kuvendin e Republikës së Kosovës.**
 - 3. Të ndryshme.**
-

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur në mbledhjen nr. 24 të KQZ-së. E kemi pikën nga mbledhja e kaluar, siç edhe jemi akorduar...Kush është për këtë rend dite...? Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht rendin e ditës.

Sa i përket raportit, tha në vazhdim znj. Daka, e hapi diskutimin. E kemi raportin, dhe shtojcën lidhur me pasqyrat financiare të plotësuar. E hapi diskutimin lidhur me këtë raport... Kush do ta merr fjalën..?

Sami Hamiti: Sa i përket kërkesës sime lidhur me plotësimet, përmirësimet, unë e kam parë materialin, dhe janë bërë përmirësime shumë të mira dhe tani e kemi një raport real...

Eshref Vishi: Raporti dhe përmbajtja e tij: ka një strukturë të detajuar dhe të standardizuar në bazë të kërkesave që ka Kuvendi i Kosovës për raportet që i dërgohen. Është gjithëpërfshirës, por është i mirë edhe në aspektin vizual. Mendoj që ka edhe ndonjë detaj që ka kaluar pa u elaboruar. Paraprakisht, kisha kërkuar vëmendje të hartuesve të raportit, që para finalizimit dhe përcjelljes në kuvend të përfshihen të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet para se raporti të përcillet për në Kuvend. Po kaloj te vërejtjet e mia:

Fq. 5: “Përmbajtja e raportit”: ...tek zyra për regjistrimin e partive politike (tek fq.14)”, është futur një tekst me dy rreshta, e që mendoj se është gabim teknik dhe se duhet të evitohet – hiqet.

Te fq. 6 (2.2.), kemi dy përshkrime të përmbajtjes që nuk përkojnë me përmbajtjen...! Të bëhet një formulim më i shkurtër...

Fq.12: kur bëhet fjalë për strukturën organizative të Sekretariatit, dhe përshkruhen emërtimet e departamenteve apo shërbimeve, duhet të përshkruhen departamentet dhe shërbimet, dhe jo emërtimet e udhëheqësve apo strukturës menaxhuese...

Fq, 13: Besoj se shpjegimi është ngarkesë, ngase e njëjta është thënë edhe në përmbajtje...Mendoj që duhet të hiqet...

Në vazhdim, z. Vishi, dha vërejtjet e tij korrigjuese – plotësuese – sugjeruese, edhe lidhur me fq. 31, dhe fq.46.

Sami Kurteshi: E kam lexuar raportin, jam munduar me kujdes, kam parë edhe raportet e viteve të kaluara për të bërë një krahasim...Raporti, kam përshtypjen se raporti është tepër i shkurtër, dhe po i nxjerrë vërejtjet e mia:

Ky raport, tha z. Kurteshi, është i shkurtër, tepër i shkurtër ka 10 faqe. Pjesa prej rreth 7 faqe, ka vetëm përmbajtje – çështje teknike. Pjesa e dytë, korniza ligjore që kur i shikon hollë e hollë, janë sikur raportet e kaluara, gati janë copy paste që nuk janë narrative, por krejt teknike! Pjesa tjetër: 13 – 19 – 20, është pjesa kryesore –

përmbajtjesore. Pjesa tjetër 21 – 28, është buxhet dhe financa, dhe ne e kemi një raport tjetër të detajuar...! E kemi një raport tjetër, pse është futur këtu, kur ketë e kemi të detajuar...? Unë mendoj që është një gabim që nuk duhet ta bëjnë institucionet e pavarura, që t'bashkohet raporti financiar me raportin narrativ, për një arsye: sepse mundet, qoftë njëri dhe qoftë tjetri për shkak të vërejtjeve përmbajtjesore - esenciale, të mos pranohet dhe të hedhet poshtë, i tërë raporti të hedhet poshtë, ndërsa që njëra pjesë mundet me qenë shumë e mirë. Raporti, duhet të ndahet...

Ajo që mua më shqetëson, është se KQZ është institucion i vetëm që i di gjithë hollësitë e organizimit të zgjedhjeve në Kosovë. Ajo e di ku janë bërë gabimet, si janë bërë... Të bëhet raporti dhe të mos përmendet asnjë problem: për shembull, rinumërimi i votave që ka shkuar deri në 90% të mos përmendet fare, problemet me votat nga diaspora – mirë – keq, që janë shkuar në procese gjyqësore, votat nga Serbia...! Unë e di, tha z. Kurteshi se, publiku ynë është marrë me çështjen se a janë të helmuara a nuk janë, kush i pruni, kush si pruni...? Mendoj që KQZ- ka shumë informata për problemet e ndryshme që paraqiten për çdo vit në zgjedhje, dhe po përmend çështjet e përgjithshme: problemet me personat e hendikepuar, votimet familjare etj. Nëse ky institucion nuk bënë rekomandime, kush duhet të bëjë...?

Raporti nuk ka asnjë fjalë lidhur me problemet, nuk ka rekomandime dhe unë propozoj që pjesa financiare, të hiqet – të veçohet...dhe se, në raport të evidentohen problemet, të gjitha sepse, përndryshe ne duhet t'i theksojmë lëshimet, të gjitha ato që bëhen dhe se duhet të fshihen në raportet e KQZ-së...

Si i këtille, tha z. Kurteshi, nuk mund të shkoj në Kuvend...

Valdete Daka: Sa për informacion: këtë raport që ne e dërgojmë është raport njoftues dhe Kuvendi nuk e aprovon...Raporti nuk është analizë, është raport evidentues e asaj që kemi punuar...Vlerësim i zgjedhjeve, është diçka tjetër dhe bëhet ndryshe...Si KQZ, ne jemi trup politike dhe po e marrë si shembull: institucioni tjetër urdhëron që “të numërohen ose të rinumërohen votat” dhe ne, e zbatojmë....Puna jonë, varet edhe nga institucionet tjera....! Ky raport, nuk është vlerësues – analizues...! Ky raport, është njoftues ! Edhe në ligj thuhet ashtu: vetëm e njofton Kuvendin...

Sami Kurteshi: Këtu në raport ka “analiza” që i bje si vetëlavdërim, ky raport tregon gjendjen e punës dhe përcjell analizën e KQZ-së të nxjerra nga përvoja e punës, jo analizën... Unë, jam duke folur për thelbin – esencën e raportit, shpjegimet që bënë KQZ për zgjedhjet...! Problemet, ato që kanë ngjarë dhe nuk janë në raport, atëherë ne kemi qasje të ndryshme. Unë, një raport pa rekomandime nuk mund ta kuptoj si raport...

Sami Hamiti: Është specifike edhe çështja e raportimit... Duhet të dihet se një kohë, deri në prill të vitit 2019, KQZ nuk ka qenë funksionale dhe nuk ka pasur plan të aprovuar, por edhe po të ishte plani i punës i aprovuar, në vërejtjet e z. Kurteshi – pjesa e parë dhe e dytë, në momentin që shpallen zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe nuk i keni në planin e punës...!? Patjetër, gjithë viti ka shkuar me zgjedhje... Te pjesa e parë: edhe në vitin 2017 edhe në vitin 2018, raportet kanë shkuar në Kuvend por nuk janë aprovuar, sepse nuk i kanë trajtuar fare... Por, formati i raportit është standard. Është gjithëpërfshirës. Ka vërejtje që duhet të përmirësohen, mirëpo në pjesën financiare është sintetike dhe analitike...Pra, nuk ka çka të hiqet sepse, raporti është mirë...pra, konsideroj që janë pjesë të specifikave të raportit...

Eshref Vishi: Është një raport, nuk bëhet fjalë për dy raporte dhe pajtohem me Samiun që thotë “ana e përgjithshme dhe ana analitike” ! Nëse dikujt i intereson, informacionet janë...

Alim Rama: Me vetë faktin që në raport nuk ka asnjë rekomandim, ndërkohë që janë mbajtur zgjedhje, mos diçka po fshihet...! Nuk pash asnjë rekomandim, dhe mendoj se raporti ka nevojë për korrigjime dhe detaje...

Analiza – përshkrimi financiar, i gjatë. Nuk ka asnjë rekomandim nga trajtimet e organizatave ndërkombëtare për zgjedhjet...Në faqen e KQZ-së, nuk janë të publikuara raportet 2017 dhe 2018...

Në vazhdim, z. Rama tha se KQZ është e obliguar ti publikoj raportet. Po ashtu, KQZ mundet të inicioj ndryshime të ligjit, për shembull ato që trajtojnë çështje administrative...? Disa ndryshime ligjore, mund të bëhen edhe jashtë reformës zgjedhore !

Më tej, z. Rama, diskutoi dhe bëri analizë rreth përmbajtjes së raportit nga faqet e raportit: 2, 12, 14, 17, 18, 19, 25, 26, 31, 36, 37, 41, 42, 43 dhe faqe 45, duke shtruar pyetje, duke dhënë mendime rreth raportit, citime nga raporti, vërejtje, sugjerime etj.

Në fund, z. Rama shtroi pyetje se, a është aprovuar ndonjë rregullore nga KQZ, a është bërë ndonjë rekomandim rreth Ligjit për Zgjedhjet...? Po ashtu, ai pyeti edhe rreth raportit financiar se pse draft – raporti i auditorit duhet me u trajtua si diçka konfidenciale, edhe pse te neni 66.9, thotë se anëtarët e KQZ-së janë ata që duhet të bartin të gjitha përgjegjësitë...Pse, anëtarët e KQZ-së nuk kanë të drejtë me e pas këtë draft – raport...?

Yll Buleshkaj: Është e vërtetë se, kemi pasur probleme për shkak të gjendjes ! Komentet e z. Vishi, janë ato që do të inkorporohen. E falënderojmë z. Vishi, disa komente të tjera janë më të vështira si cilësime, nuk është 10 faqe raporti, pastaj nuk mund të bëjmë më shumë sepse, ne kemi një shabllon që e realizojmë sipas një

kornize...Në disa raporte kemi pasur rekomandime të cilat, ndoshta janë përsëritë 5 vite...Raporti ka lëshime teknike që përmirësohen...!

KQZ, nuk mund të inicioje ndryshim të legjislacionit, por mundemi të atij të brendshëm sekondare...

Valdete Daka: Po të ndërpres: Kur ka qenë funksional Komisioni për Reformën Zgjedhore dhe Reformën Kushtetuese, edhe në raporte ne e kemi cekur që unë kam qenë kryetare e atij Grupi Punës. Pra, ne nuk mundemi me ndryshua ligje, por ne mund ta japim kontributin tonë...

Yll Buleshkaj: U përmend pjesa financiare që duket se është në dy vende, por është aneks, nuk është e ndarë...I kemi kushtuar rëndësi më të madhe, për shkak se financat janë çështje e ndjeshme... Ne, mund ta finalizojmë raportin sa do që ne mund të diskutojmë dhe të vazhdojmë pa fund me pyetje dhe përgjigje...

Valdete Daka: Në faqen tonë zyrtare, dalin vendimet. Raportet, meqë nuk janë të aprovuara, ne nuk mund t'i publikojmë... U përmenden helmimet: ne nuk mundemi me u marrë me këtë çështje, por ne nuk mundemi me bërë as analizë dhe as konstatime, sepse kjo është çështje e Prokurorisë...

Vendimet e PAZP-së, të Gjykatës Supreme etj., janë vendime që ne s'mundemi me i refuzue...Ne, s'mund t'i komentojmë ato, as të japim opinione... Si KQZ në asnjë mënyrë...!

Čemailj Kurtishi: Si i tërë, raporti mendoj që është në rregull, pavarësisht vërejtjeve ! Në fjalën e tij, z. Kurtishi, analizoi përmbajtje nga raporti në fq. 12, dhe kërkoi që të potencohet entiteti boshnjak, si i treti në vend dhe për të cilën nuk ka asnjë fjalë...

Në debat, u diskutua më tej dhe u dhanë edhe përgjigjeve që kishin të bënin rreth konfidencialitetit të dokumenteve të caktuara, siç në këtë rast është fjala për raportin e Auditorit. Mirëpo, rreth kësaj pati mospajtime nga z. Sami Kurteshi, i cili, kërkoi bazën ligjore rreth kësaj.

Në diskutim, u angazhua edhe Sami Hamiti, i cili shpjegoi se pse dokumenti ka rëndësi të konfidencialitetit, dhe se pse një dokument u dërgohet personave të caktuar.

Por, z. Kurteshi tha se në momentin kur dëshmohet se ka një dokument ose bazë ligjore që është e ndaluar, pra në këtë rast për mua si anëtarë i KQZ-së në rregull, përndryshe nuk pajtohem...

Eshtrëf Vishi: Kemi të bëjmë me procedurën kur një dokument bëhet final: në momentin kur e përfundon punën auditori i jashtëm dhe e bënë raportin, një draft raport ku evidenton të gjitha të gjeturat, është një afat ligjor që Sekretariati dhe personat e tjerë, duhet t'i japin komentet në të gjeturat në draft...Në këtë fazë, më duket 30 ditore, nëse ti nuk jep përgjigje, vetvetiu dokumenti është bërë final...Në momentin kur konsiderohet final, nuk është më i fshehtë...

Anëtarët e KQZ-së pastaj, kanë të drejtë ta kenë...!

Arianit Elshani: Sido qoftë, rreth komenteve të bëra lidhur me korrigjimet, më shumë nga ana teknike...Tjetra: lidhur me rekomandimet e KQZ-së, ne nuk mund ti bëjmë ato pa i bërë ne këtu në linja të caktuar...Pajtohem që duhet të kemi rekomandime por, ato duhet të dihen si, qysh, pse...pra, pa pas një bazë të caktuar... Na lejohet në bazë të ligjit, por duhet të jemi të qartë dhe të saktë në rekomandime...

Në vazhdim, z. Elshani, bëri analizën e tij rreth vërejtjeve të caktuara, dhe problemeve të caktuara si, çështja e karantinimit të votave – helmimit të tyre...!

Rrethanat na kanë imponuar, tha z. Elshani dhe para vetës kemi kohë të shkurtër, por që në parim pajtohem që ta miratojmë raportin, duke i inkorporuar vërejtjet që janë dhënë...

Ibrahim Selmanaj: Ne kemi të bëjmë me një raport ku paraqitet një gjendje reale, dhe unë e respektoj punën që është bërë...Ka mangësi, por disa vërejtje mund të inkorporohen...Kemi qenë në gjendje emergjente, por po respektohen afatet ligjore... Me propozime konkrete, kompletohet raporti, dhe mendoj që si i tillë duhet të aprovohet ! Pavarësisht që, unë skam qenë anëtarë i KQZ-së në vitin 2019, unë do ta aprovojë si të këtillë...

Valdete Daka: Mbi të gjitha, ne nuk mund të hartojmë një raport ku ne mund të shfaqim dhe inkorporojmë aty analiza politike, rekomandime që lidhen me interesa të caktuara, sepse ne nuk jemi trupë politike, aq më shumë të lëshohemi në analiza të vendimeve që nuk i kemi marrë ne...Ne, as s'mund ta mohojmë dhe as s'mund ta analizojmë pse e qysh, ta zëmë një vendim të PZAP-së...

Debati më tutje, u zhvillua mes anëtarëve të KQZ-së në dimensionet e zërthimeve, konstatimeve, kundërshtimeve etj., brenda rolit të KQZ-së, proceseve zgjedhore, aspekteve ligjore, vendimeve të institucioneve jashtë KQZ-së, rolin e këtyre institucioneve etj.

Artan Asllani: Unë, falënderoj Sekretariatën për raportin ! Raportet bëhen në bazë të një forme, kornize ! Besoj që ky është një raport i mirë, i kuptueshëm dhe,

mendoj se po shpenzojmë energji shumë në ato që, s'varen nga ne. Të vazhdojmë me punët që varen nga ne, nga ne si anëtarë të KQZ-së...

Sami Hamiti: Rreth një çështjeve: u dëgjova me Zyrën e Auditimit. Drafti, u jepet specifikisht personave të caktuar, deri sa bëhet final me të gjitha specifikat...

Valdete Daka: Më duket që, kemi diskutuar mjaftueshëm rreth raportit. I kemi disa vërejtje që duhet të merren parasysh, disa të tjera nuk janë të mundshme...kështu që, nëse pajtoheni unë e kisha hedhur në votim raportin... Paraprakisht, një kaptinë e sfidave të listohet dhe të na dërgohet...Mirëpo, në parim mendoj që duhet ta aprovojmë...

Nuk mund të mbesim peng i kërkesave që nuk janë reale. Ato çka janë konkrete duhet të inkorporohen...

Sami Hamiti: Në raport, duhet të hyjnë ato kërkesa që janë reale...

Arianit Elshani: Parimisht, duhet të pajtohem me disa pika që po duam me i ndryshue, sepse nuk mundemi me e lënë kështu të hapur...

Valdete Daka: Ishin disa kërkesa konkrete, si ajo në fa. 5 tek paria politike, fq. 13, fq.14, pra ishin disa çështje teknike...Janë marrë këtu edhe shënimet nga Kryeshefi...

Në anën tjetër, tha znj. Daka, konsideroj që rekomandimet për Kuvendin nuk mund të bëhet për çdo pikë, kurse ne mund ta specifikojmë si pjesë të raportit kërkesën për nevojën për Reformë Zgjedhore, si një kërkesë imediate nga nevojat që kanë dalë qysh prej disa viteve...Madje, duke u bazuar edhe në rekomandimet e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, si Bashkimi Evropian...

Ju lutem, e qesë në votim raportin me vërejtjet që u dhanë...Kush është për...?

Anëtarët e KQZ me tetë (8) vota për, 2 vota kundër, u aprovua në parim.

